



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2022:237972

Datë: 26.02.2025

Numri i dokumentit: 06909238

C.nr. 280/2022

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – DEGA NË KAMENICË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtaren Valbonë Dërvodeli, dhe bashkëpunëtorin profesional Blerand Sopi, në çështjen juridike kontestimore të paditësve, Sh.K., R. K., V.K., M. K. dhe N. Sh. me përfaqësues ligjor M.K., që të gjithë nga, të cilët me autorizim i përfaqëson Nysret Islami avokat në Prishtinë me adresë Rr.”Holger Pedersen” Hyrja-3 Kati-2 nr.8 në Prishtinë, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “PRISIG”, me seli në Prishtinë, Rr. Eduard Lir 173, Lagjja Arbëria, me objekt kontesti për kompensimin e dëmit material dhe jo material, me vlerë të kontestit prej 74,095.10 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik, më datën 18.02.2025 përpilojë këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT si e bazuar kërkesëpadia e paditësve, Sh. K., R. K., V. K., M. K., dhe N. Sh. të gjithë nga dhe **DETYROHET** e paditura Kompania e Sigurimeve “PRISIG” me seli në Prishtinë, që në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material, të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 20.08.2022, që ka ndodhur në Hyrje të fshatit Hodonoc, që e ka shkaktuar i siguruari i saj – vozitësi E. K., t’ia paguaj paditësve shumat si në vijim:

Për paditësin Sh. K.

- **Në emër të dëmit jo material:**
- Për dhimbjet e përjetuara fizike – trupore, shumën prej.....4,000.00 (katërmijë) euro,
- Për friken e përjetuar, shumën prej.....3,000.00 (tremijë) euro,

- Në emër të zvoglimit të aktivitetit jetësor për 14.50% shumën prej 9,000.00 (nëntëmijë) euro
- Në emër të shëmtimit shumën prej3,000.00 euro (tremijë)
- **Në emër të dëmit material:**
 - Në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj, për 60 ditë, shumën prej..... 900.00 euro (nëntëqind)
 - Në emër të ushqimit të përforcuar për 60 ditë, shumën prej 800.00 euro (tetëqind)
 - Në emër të shpenzimeve për rehabilitim fizioterapik, shumën prej2,400.00 euro (dymijë e katërqind)
 - Në emër të shpenzimet e shërimit-mjekimit sipas faturave dhe kuponëve fiskal shumën prej956.00 euro (nëntëqind e pesëdhjetegjashtë)
 -
- **Për paditësen R. K.**
 - **Në emër të dëmit jo material:**
 - Për dhimbjet e përjetuara fizike – trupore, shumën prej.....500.00 (pesëqind) euro,
 - Për friken e përjetuar, shumën prej.....300.00 (treqind) euro,
 - **Në emër të dëmit material:**
 - Në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj, për 15 ditë, shumën prej..... 300.00 (treqind) euro
 - Në emër të ushqimit të përforcuar për 16 ditë, shumën prej4,00.00 euro (katërqind)
 - Në emër të shpenzimeve për rehabilitim fizioterapik, shumën prej100.00 euro (njëqind)
 - Në emër të shpenzimet e shërimit-mjekimit sipas faturave dhe kuponëve fiskal shumën prej39.00 euro (tridhjetenëntë)

Për paditësin e V.K.

- Në emër të dëmit jo material:

- Për dhimbjet e përjetuara fizike – trupore, shumën prej.....400.00 (katërqind) euro,
- Për friken e përjetuar, shumën prej.....300.00 (treqind) euro,

- Në emër të dëmit material:

- Në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj, për 15 ditë, shumën prej..... 300.00 (treqind)
- Në emër të ushqimit të përforcuar për 20 ditë, shumën prej..... 300.00 (treqind)
- Në emër të shpenzimet e shërimit-mjekimit sipas faturave dhe kuponëve fiskal shumën prej76.00 euro (shtatëdhjetë e gjashtë)

Për paditësen M.K.

- Për dhimbjet e përjetuara fizike – trupore, shumën prej.....3,000.00 (tremijë) euro,
- Për friken e përjetuar, shumën prej.....2,500.00 (dymijepesëqind) euro,
- Në emër të zvogëlimit të aktivitetit jetësor për 10% shumën prej3,000.00 (tremijë) euro
- Në emër të shëmtimit shumën prej1,000.00 euro (njëmijë)

Në emër të dëmit material:

- Në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj, për 30 ditë, shumën prej..... 400.00 euro (katërqind)
- Në emër të ushqimit të përforcuar për 40 ditë, shumën prej..... 400.00 euro (katërqind)
- Në emër të shpenzimeve për rehabilitim fizioterapik, shumën prej..... 1,500.00 euro (njëmijë e pesëqind)

- Në emër të shpenzimet e shërimit-mjekimit sipas faturave dhe kuponëve fiskal shumë
..... prej 903.00 euro (nëntëqind e tre)

Për paditësin e mitur N. Sh.

- Për dhimbjet e përjetuara fizike – trupore, shumë prej.....300.00 (treqind) euro,
- Për friken e përjetuar, shumë prej.....100.00 (njëqind) euro,
- **Në emër të dëmit material:**
 - Në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj, për 10 ditë, shumë prej..... 200.00 euro (dyqind)
 - Në emër të ushqimit të përforcuar për 20 ditë, shumë prej 200.00 euro (dyqind)

II. DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “PRISIG” me seli në Prishtinë, që t’ia paguaj shumat e gjykuara paditëseve si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në shumë e përgjithshme prej 40,574.00 (katërdhjetëmijë e pesëqind e shtatëdhjetë e katër) euro, me kamatë ligjore prej 8%, ku për dëmin jo material llogaritet nga data e marrjes së aktgjykimit, ndërsa për dëmin material nga data e dorëzimit të padisë në gjykatë, e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh, pas datës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të ekzekutimit me detyrim

III. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë e paditësve, në shumë prej 33,521.10 (tridhjetë e tremijë e pesëqind e njëzetënjë euro) e dhjetë cent, shumë kjo përtej shumës së gjykuar si në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, **SI TËRËSISHT E PABAZUAR.**

IV. DETYROHET Kompania e Sigurimeve “PRISIG” me seli në Prishtinë, që paditësve të ja paguaj shumë prej 1,988.00 (njëmijë e nëntëqind e tetëdhjetë e tetë euro) në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, brenda afatit prej 15 ditësh, pas datës së pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit me detyrim.

A r s y e t i m

Paditësit, Sh. K., R.K., V. K., M. K. dhe N. Sh. me përfaqësues ligjor M.K., që të gjithë nga përmes të autorizuarit të tyre, më datën 11.11.2022, në këtë gjykatë, kanë parashtruar padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “PRISIG”, me seli në Prishtinë, për kompensimin e dëmit material dhe jo material, me vlerë të kontestit prej 74,095.10 euro.

I. Pretendimet e palëve ndërgjyqjese

I autorizuari i paditësve, avokati Nysret Islami avokat në Prishtinë në seancën përgatitore dhe gjatë seancës të shqyrtimit kryesor dhe fjalën përfundimtare ka deklaruar se, mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, duke theksuar se nga e paditura nuk është kontestuese baza juridike e kërkesëpadisë dhe se pas propozimit për nxjerrjen e ekspertizave mjekoligjore nga Dr.Luan Kuqi Ortoped – Traumatolog dhe Dr.Shaban Mecinaj Psikiatër, të njëjtit në ekspertizën e tyre e kanë dhënë mendimin dhe konstatimin e tyre duke u bazuar në dokumentacionin mjekësor dhe ekzaminimin direkt të paditësve dhe po ashtu të njëjtit kanë mbetur pranë ekspertizës së tyre edhe në seancën e datës 03.02.2025 ashtu që nga shkresat e lëndës e veçanërisht nga ekspertiza mjekësore është vërtetuar pa mëdyshje se paditësit kanë pësuar lëndime trupore të cilat ju kanë shkaktuar, dhimbje fizike, frikë, shëmtim trupor, zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor e po ashtu të njëjtit kanë pasur nevojë për ushqim të përforcuar, për ndihmë të personit të tretë, për rehabilitim klimaterik dhe të njëjtit kanë bërë shpenzime materiale, andaj në parashtrësën për precizimin e shumave të kërkesëpadisë paditësit janë bazuar në nenet 136,140,159,173,177 par 2 dhe 183, Nenit 26 paragrafi 6 të Ligjit mbi Auto përgjegjësinë si dhe udhëzuesit të Gjykatës Supreme të datës 27.02.2023 për caktimin e kriterëve orientuese dhe lartësinë e shpërblimit të drejtë në të holla të dëmit jo material dhe në ekspertizën mjekësore, prandaj i ka propozuar gjykatës që të aprovet kërkesëpadija e paditësve Sh. K., R.K., V. K., M.K. – Sh.dhe N. Sh. në tërësi si e bazuar si dhe të detyrohet e paditura që për shkak të lëndimeve si pasojë e aksidentit të datës 20.08.2022 paditësve t’ua paguaj dëmin material dhe jo material si në parashtrësën e dorëzuar në seancën e datës 03.02.2025 dhe atë në shumë totale prej 74,095.10 euro, me kamatë ligjore prej 8% e cila të llogaritet nga data e paraqitjes së padisë, deri në pagesën përfundimtare. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në shumë prej 3,720.40 euro.

I autorizuari i të paditurës në seancën përgatitore dhe gjatë seancës të shqyrtimit kryesor dhe fjalën përfundimtare ka deklaruar se, mbetet në tërësi pranë përgjigjes në padi dhe deklarimeve gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor, duke theksuar se paditura gjeneralisht për të gjithë paditësit

e konteston lartësinë e kërkesëpadisë sepse shuma e përgjithshme e cila është kërkuar me anë të precizimit të kërkesëpadisë për paditësit dhe atë, për dhimbje trupore, frikën e përjetuar, zvogëlimin e aktivitetit jetësor dhe shëmtim është jashtëzakonisht e lartë dhe në kundërshtim direkt me nenin 183 par.2 të LMD-së, i cili parasheh se me rastin e vendosjes së kërkesës për shpërblim të demit jo material, si dhe lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se me të, të mos favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj, andaj vlerësojmë se shumatat e kërkuara bien në kundërshtimin me qëllimin e përmendur si dhe me kriteret për vlerësimin e dëmeve jo materiale të përcaktuara me Rregulloren e BQK-së, e miratuar me datë 31 gusht 2016, kërkesat e paditësve për dëmin material lidhur me ndihmën e personit të tretë, ushqimin e përforcuar, po ashtu i kundërshtojnë si të larta, pasi që për kërkesat e tilla lidhur me shërbimet që merren brenda familjes ekziston një praktikë e unifikuar që të pranohet kompensimi në shumë prej 5 Euro, për ditët e caktuar nga eksperti, dhe se i kundërshton shpenzimet e mjekimit në shumën e specifikuar sepse të njëjtat nuk janë specifikuar nga ekspertizat e nxjerra në procedurë gjyqësore, po ashtu i kundërshton shpenzimet për terapi fizikale në mungesë të provave materiale, e Paditura në mënyrë specifike e kundërshton lartësinë e kërkesëpadisë – precizimin e kërkesëpadisë dhe atë si vijon: Për paditësin Sh. K., nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës qartazi vërehet se lëndimi i pretenduar si ”thyerja e shumëfishtë e acetabulimit të djathtë” nuk është i evidentuar nga Spitali i Përgjithshëm i Gjilanit i datës 20.08.2022 ora 18:20 (një orë pas aksidentit), por i njëjti lëndim i pretenduar është evidentuar pas 11 ditëve dhe atë me datë 31.08.2022 në QKUK. Lidhur me çështjen e lartcekur në seancën e datës 03.02.2025 kemi parashtruar pyetje për ekspertin nga lëmia e ortopedisë ku i njëjti në pyetjen e përfaqësuesit të paditurës se ”duke u ndërlidhur me pyetjen paraprake a mund të na sqaroni përfundimisht se diagnoza e sipërcituar, a është evidentuar në Emergjencën në Gjilan ku është pranuar me datën e aksidentit 20.08.2022, apo pas pranimit në QKUK me datën 31.08.2022 konkretisht pas 11 ditëve?”, është përgjigjur: ”në raportin e Qendrës Emergjente të Gjilanit nuk është konstatuar thyerje e sipërshënuar...” Pra, nga vetë përgjigja e ekspertit vërtetohet në mënyrë të pakontestueshme se lëndimet e tilla nuk janë diagnostifikuar pas aksidentit, por shumë ditë pas aksidentit. Andaj bazuar në shkresat e lëndës, mendimit të ekspertit dhe përgjigjeve të të njëjtit ka paqartësi sepse: Si është e mundur që paditësi të qëndroj me thyerje të shumta (multifraktura) për më shumë se 10 ditë? Si është e mundur që një dëmtim i tillë të vërehet nga një institucion privat dhe jo nga Qendra Emergjente e Gjilanit? Si është e mundur që paditësi pranohet me datë 31.08.2022 në QKUK, por në asnjë pjesë të raportit mjekësor nuk theksohet se lëndimet e tilla janë pasojë e aksidentit të trafikut?(siç shënohet gjithmonë) Pra, nga të lartcekurat konkludohet

se eksperti nuk ka arritur në asnjë mënyrë të bëjë lidhjen kauzale në mes lëndimeve të pretenduara dhe ditës së aksidentit. I kundërshtojmë kërkesat në emër të kategorive të dëmit material dhe jo material si jashtëzakonisht të rënda, në veçanti shumën e kërkuar në emër të shëmtimit sepse i njëjti shëmtimin e ka në zonë jo të dukshme për personat e tjerë, ndërsa kërkesa e paditësit tejkalon çdo limit të paraparë me Udhëzuesin e Gjykatës Supreme, legjislacionit në fuqi dhe praktikës gjyqësore. Po ashtu shuma në emër të rehabilitimit klimaterik është tërësisht e pa bazuar sepse në shkresat e lëndës NUK ka asnjë provë/dëshmi (faturë, kupon fiskal) se i njëjti ka kryer shërbim të tillë, andaj një kërkesë e tillë paushalle duhet të refuzohet. Shpenzimet materiale sipas faturave në shumë prej 956.50 euro nuk janë të specifikuara me numër serik dhe shuma specifike dhe të njëjtat nuk janë të llogaritura nga eksperti financiar, andaj si të tilla janë të papranueshme dhe kërkesa e tillë duhet të refuzohet. Ndërsa lartësitë për kategoritë e tjera të dëmit nuk janë në raport me lëndimet e paditësit, andaj të njëjtat duhet të refuzohet përtej shumave të cilat tejkalojnë qëllimin e satisfaksionit. Për paditësin N.Sh.: Lartësia e kërkuar në emër të frikës nuk përkon me të gjeturat e ekspertit nga lëmia e psikiatrisë ngase i njëjti nuk ka përcaktuar ndonjë kohëzgjatje për frikën primare dhe si e tillë një kërkesë e tillë duhet të refuzohet. Ndërsa lartësia e potencuar për dhimbje fizike është jashtëzakonisht e lartë sepse i njëjti ka pësuar vetëm lëndime të lehta sipërfaqësore. Ndërsa për paditësit e tjerë, për secilin veç e veç i kundërshtojmë shumat e kërkuara në emër të dëmit jo material si tejet të larta, jo në proporcion me lëndimet e pësuar dhe si kërkesa shabllonike, i kundërshtojmë në tërësi kërkesat në emër të shpenzimeve mjekësore dhe rehabilitimit klimaterik si të pa provuara me asnjë provë. Sa i përket shpenzimeve të procedurës gjykatës i propozojmë që me rastin e vendosjes lidhur me njohjen ose jo të shpenzimeve të paditësve të marrë parasysh suksesin e paditësit në realizimin e kërkesëpadisë ashtu siç e parasheh neni 452.2 i ligjit Nr. 03/L-006 për procedurën kontestimore, ku përcaktohet se: *"Po qe se paditësi vetëm pjesërisht ka sukses në procesin gjyqësor, atëherë gjykata mundet, duke marrë parasysh suksesin e arritur, të caktojë që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta apo që njëra palë t'ia shpërblejë tjetrës, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, pjesën proporcionale të shpenzimeve."* Pra, nëqoftëse paditësve nuk iu aprovohet në tërësi lartësia e kërkuar, të përpjesëtohen edhe shpenzimet procedurale aq sa të njëjtit kanë pasur sukses. Në mënyrë specifike i kundërshtojmë shpenzimet në emër të precizimit të kërkesëpadisë sepse një kërkesë/shpenzim i tillë është veçse i konsumuar me kërkesën në emër të përpilimit të padisë dhe njohja e një shpenzimi të tillë nënkupton që për të njëjtin shpenzim të paguhet dy herë. Sa i përket kamatës i propozojmë gjykatës që me rastin e vendosjes të ketë parasysh mendimin e Gjykatës Supreme lidhur me kamatën ku kamata nuk llogaritet nga dita e padisë, por nga dita kur merret aktgjykimi në shkallë të parë. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar

2. Provat e administruara në shqyrtimin kryesor

Gjykata për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore, në shqyrtimin kryesor i ka administruar këto prova materiale: Certifikata e lindjes me nr.ref.4/2020RL/4001 e dt.10.11.2022, e ne emër të N. Sh., Raporti i aksidentit me nr.2022-CR-658, i dt.20.08.2022, Raporti i Spitalit të përgjithshëm Gjilan Emergjencia me nr, te prot. 19254 e dt.20.08.2022, ne emër të Sh. K., Fletëlëshimi i QKUK-së Klinika e ortopedisë dhe traumatologjisë lokomotore Prishtine me nr. te historisë 1485, ne emër të Sh.K., data e mjekimit 31.08.2022 deri me 16.09.2022 Analiza laboratorike ORT.RE te dt.09.09.2022 ne emër të Sh.K., Raporti i QKUK Prishtine ne emër të Sh. K. me nr.1485 dt.08.09.2022, Fatura e barnatores SH.P.K LAYO , e dt.09.09.2022, Raport nga ordianca specialistike e ortopedisë dhe fizioterapi ne emër të Sh. K. edt.29.08.2022, si dhe bashkangjitur kuponi fiskal. Udhëzimi i mjekut lëshuar nga QMF- Roganë me dt.29.08.2022, ne emër të Sh. K., si dhe termini i caktuar për date 29.08.2022 tek Dr.Rinor Velekinca, Udhëzimi i QMF- Roganë i dt.29.08.2022, te dr. Psikiatër, Raporti mjekësor te spitalit regjional Gjilan – Klinika e psikiatrisë ne emër të Shefik Kastrati i dt.29.08.2022, Raporti SWISS Hospital ne emër të Sh. K. i dt.29.08.2022, Raport specialitik neurologjik poliklinika denta med ne emër të Sh. K. i dt.29.08.2022, Udhëzim i QMF Roganë për te specialisti i dt.20.08.2022, 6 Dëftesat për pagimin e participimit, 14 Kupona fiskal Raporti i Spitalit të përgjithshëm Gjilan me nr. te prot.19248, i dt.20.08.2022, ne emër të Rahime Kastrati Raporti specialistik neurologjik i poliklinikës mjekësore Denta Med i ne emër të R. K. i dt.29.08.2022 Udhëzimi i QMF Roganë i dt.29.08.2022, ne emër të R.K.. Raport mjekësor i Spitalit të përgjithshëm Gjilan – klinika e psikiatrisë ne emër të R. K.i dt.29.08.2022 Raport nga ordianca specialistike e ortopedisë dhe fizioterapi ne emër të R. K. edt.29.08.2022, 3 Kuponat fiskal dhe 2 dëftesë pagesa, Raporti i Spitalit të përgjithshëm Gjilan me nr. te prot.19244, i dt.20.08.2022, ne emër të V. K., Raporti specialistik neurologjik i poliklinikës mjekësore Denta Med i ne emër të V. K.i dt.29.08.2022, Udhëzimi i QMF Roganë i dt.29.08.2022, ne emër të V. K., Raporti mjekësore i Spitalit të përgjithshëm Gjilan – klinika e psikiatrisë ne emër të V. K. i dt.29.08.2022, Raport nga ordianca specialistike e ortopedisë dhe fizioterapi ne emër të V.K. e dt.29.08.2022, 5 Kupona fiskal dhe 2 dëftesë pagesa, Fletë lëshim i spitalit të përgjithshëm Gjilan – Reparti i ortopedisë ne emër të M. Sh. data e pranimit 20.08.2022 data e lëshimit 25.08.2022, fature me nr.F-1081/22 dt.24.08.2022, ne emër të M. K. Sh., Udhëzim i QKMF –së Gjilan i dt.26.08.2022, ne emër të M. K., Udhëzim i spitalit të përgjithshëm Gjilan me nr. te regjistrimit 5736 ne emër të M. K., i dt.20.08.2022, Raport psikologjik i spitalit të përgjithshëm Gjilan ne emër të M. K., i dt.01.11.2022, Udhëzimi për konsulta me fiziatriin ne emër të M. K., Raport nga

konsulta i dt.10.10.2022, ne emër te M. K., Spitali i përgjithshëm Gjilan, Raport nga konsulta i dt.19.09.2022, ne emër te M.K., Spitali i përgjithshëm Gjilan, 10 Dëftesë pagesa ne emër te M. Sh.K., 9 Kupona fiskal, 2 receta për barna ne emër te M. Sh. i dt.13.09.2022, Fletë lëshimi i spitalit te përgjithshëm Gjilan me nr. te prot.19250 e dt.20.08.2022 ne emër te N. Sh., Udhëzim i QMF –së Roganë i dt.20.08.2022, ne emër të N. Sh., Raport psikologjik i spitalit te përgjithshëm Gjilan ne emër të N. Sh. i dt.01.11.2022, 4 Kupona fiskal, Ekspertiza e ortopedisë dhe të psikiatrisë e dt.30.10.2024, deklarimi i ekspertit të psikiatrisë Dr.Shaban Mecinaj dhe deklarimi i ekspertit të ortopedisë Dr.Luan Kuqi.

Gjykata, pas analizimit dhe vlerësimit të pohimeve të të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, si dhe provave materiale të lartcekura, në kuptim të dispozitës së nenit 8, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku dhe ka gjetur se padia dhe kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e bazuar në ligj.

Gjykata ka konstatuar se në mes palëve ndërgjyqëse, nuk ishte kontestuese baza juridike e kërkesëpadisë së paditëses, por, për palën e paditur kontestuese ishte lartësia e kërkesëpadisë së palës paditëse në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material.

Në bazë të certifikatës së lindjes me nr.ref.4/2020RL/4001 e dt.10.11.2022,e ne emër te Nino Shabani, gjykata vërtetoi faktin se N. Sh. ka lindur me datë 21.04.2020 në Gjilan, nga babai L.Sh. dhe nëna M.K. Sh..

Në bazë të Raporti i aksidentit me nr.2022-CR-658, i dt.20.08.2022, gjykata vërtetoi faktin se me datë 20.08.2022 në hyrje të fshatit Hodonoc, Nj.A ishte duke lëvizur në rrugën lokale Crep – Rogoçicë dhe me të arritur në hyrje të fshatit Hodonoc, afër pikës së karburanteve “Ismajli Petroll” fillon tejkalim të pa sigurtë në vijë të plotë dhe në këtë situatë ndeshet në mënyrë ballore me njësinë “B” e cila në momentin kritik ishte duke lëvizur në relacionin Rogoçicë – Crep dhe ishte në shiritin e vet qarkullues, ku si pasojë e këtyre veprimeve shkaktohet aksident trafiku me dëme materiale në të dyja njësitë dhe lëndime trupor pësojnë të dy drejtuesit dhe pasagjerët e njësisë “B”.

Në bazë të faturave, kuponëve fiskal dhe dëftesave për pagimin e participimit, gjykata vërtetoi faktin e shpenzimeve financiare të paguara nga paditësit, për mjekim dhe rehabilitim sipas kuponëve të lartcekur.

Në bazë të Raporti i Spitalit te përgjithshëm Gjilan Emergjencia me nr, te prot. 19254 e dt.20.08.2022, ne emër te Sh.K., Fletë lëshimi i QKUK-së Klinika e ortopedisë dhe

traumatologjisë lokomotore Prishtine me nr. te historisë 1485, ne emër te Sh.K., data e mjekimit 31.08.2022 deri me 16.09.2022 Analiza laboratorike ORT.RE te dt.09.09.2022 ne emër te Sh. K., Raporti i QKUK Prishtine ne emër te Sh.K. me nr.1485 dt.08.09.2022, Udhëzimi i mjekut lëshuar nga QMF- Roganë me dt.29.08.2022, ne emër te Sh.K., si dhe termini i caktuar për date 29.08.2022 tek Dr.R. V.a, Udhëzimi i QMF- Roganë i dt.29.08.2022, te dr. Psikiatër, Raporti mjekësor te spitalit regjional Gjilan – Klinika e psikiatrisë ne emër te Sh. K. i dt.29.08.2022, Raporti SWISS Hospital ne emër te Sh. K.i dt.29.08.2022, Raport specialistik neurologjik poliklinika denta med ne emër te Sh. K.i dt.29.08.2022, Udhëzim i QMF Roganë për te specialisti i dt.20.08.2022, Raporti i Spitalit i përgjithshëm Gjilan me nr. te prot.19248, i dt.20.08.2022, ne emër te R. K., Raporti specialistik neurologjik i poliklinikës mjekësore Denta Med i ne emër te R. K. i dt.29.08.2022 Udhëzimi i QMF Roganë i dt.29.08.2022, ne emër te R. K.. Raport mjekësore i Spitalit te përgjithshëm Gjilan – klinika e psikiatrisë ne emër te R.K. i dt.29.08.2022 Raport nga ordianca specialistike e ortopedisë dhe fizioterapi ne emër te R. K. dt.29.08.2022, Raporti i Spitalit i përgjithshëm Gjilan me nr. te prot.19244, i dt.20.08.2022, ne emër te V. K., Raporti specialistik neurologjik i poliklinikës mjekësore Denta Med i ne emër te V. K.i dt.29.08.2022, Udhëzimi i QMF Roganë i dt.29.08.2022, ne emër te V. K., Raporti mjekësor i Spitalit te përgjithshëm Gjilan – klinika e psikiatrisë ne emër te V.K. i dt.29.08.2022, Raport nga ordianca specialistike e ortopedisë dhe fizioterapi ne emër te V. K. e dt.29.08.2022, 5 Kupona fiskal dhe 2 dëftesë pagesa, Fletë lëshim i spitalit te përgjithshëm Gjilan – Reparti i ortopedisë ne emër te M.Sh.data e pranimit 20.08.2022 data e lëshimit 25.08.2022, fature me nr.F-1081/22 dt.24.08.2022, ne emër te M. K. Sh., Udhëzim i QKMF – së Gjilan i dt.26.08.2022, ne emër te M. K., Udhëzim i spitalit te përgjithshëm Gjilan me nr. te regjistrimit 5736 ne emër te M. K., i dt.20.08.2022, Raport psikologjik i spitalit te përgjithshëm Gjilan ne emër te M. K., i dt.01.11.2022, Udhëzimi për konsulta me fiziatrin ne emër te M.K., Raport nga konsulta i dt.10.10.2022, ne emër te M. K., Spitali i përgjithshëm Gjilan, Raport nga konsulta i dt.19.09.2022, ne emër te M. K., Spitali i përgjithshëm Gjilan, Fletë lëshim i spitalit te përgjithshëm Gjilan me nr. te prot.19250 e dt.20.08.2022 ne emër te N. Sh., Udhëzim i QMF –së Roganë i dt.20.08.2022, ne emër të N. Sh., Raport psikologjik i spitalit te përgjithshëm Gjilan ne emër të N.Sh. i dt.01.11.2022, gjykata vërtetoi faktin se fillimisht paditësit kishin kërkuar ndihmë mjekësore pranë Spitalit të përgjithshëm në Gjilan-Emergjencia, të cilëve u ishte përshkruar diagnoza si në shkresat e lëndës, pastaj të njëjtit kishin vazhduar me trajtimet mjekësore, duke u konstatuar kështu lëndimet si në ekspertizën e ortopedisë dhe të psikiatrisë e dt.30.10.2024 të pranuar nga kjo gjykatë.

Në bazë të ekspertizës së ortopedisë dhe të psikiatrisë e dt.30.10.2024 të pranuar nga kjo gjykatë në emër të paditësve, Sh. K., R. K., V. K., M. Sh. K. dhe N. K., gjykata vërtetoi faktin se ekspertët e lartcekur kanë konstatuar se për paditësin Sh.K., dëmtimet e pësuar nga aksidenti i datës 20.08.2022 paraqesin dëmtime të rënda trupore, ashtu që i njëjti kishte pësuar plagë shqyese dërmishëse në regjionin ballor majtas e qepur dhe therje të shumëfishtë e acetabulumit të djathtë, dhe kishte pësuar zvogëlim të aktivitetit jetësor 14.50% për shkak të lëvizshmërisë së kufizuar të kërdhokullësë së djathtë në shkallë të mesme pika 2.2.2 b si dhe dhimbjes së përhershme për shkak të thyerjes së kockës ischiatike pika 4.1.1 dhe përlllogaritur sipas Balthazard, i njëjti kishte pësuar dhembje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë 1 orë, të intensitetit të rëndë 15 ditë, të intensitetit të mesëm 60 ditë ndërsa dhimbjet fizike të intensitetit të ultë janë të pranishme edhe në ditët e sotme sidomos gjatë ndryshimeve klimatike, kishte pësuar shëmtim trupor të shkallës së mesme, dhe frikë primare të intensitetit posaçërisht të lartë disa sekonda, intensitetit të lartë në kohëzgjatje 40 minuta, intensitetit të mesëm 4 javë ndërsa frika e intensitetit të ulët vazhdon ende, për të njëjtin kishte qenë e nevojshme përkujdesja e personit tjetër në kohëzgjatje prej 60 ditëve, ndërsa kishte pasur nevojë për ushqim të përforcuar në kohëzgjatje prej 60 ditëve, ndërsa rehabilitimi fizioterapeutik kishte qenë i nevojshëm për 3x10 ditë në vitin e parë dhe 2x10 ditë në vitin e dytë, ndërsa 10 ditë për 3 vitet tjera. Dëmtimet e pësuar R. K. nga aksidenti i datës 20.08.2022 paraqesin dëmtime të lehta trupore, ashtu që e njëjta nuk kishte pësuar zvogëlim të aktivitetit jetësor ndërsa, kishte pësuar dhembje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë 30 minuta, të intensitetit të rëndë 5 ditë, të intensitetit të mesëm 25 ditë ndërsa dhimbjet fizike të intensitetit të ultë janë të pranishme edhe në ditët e sotme sidomos gjatë ndryshimeve klimatike, shëmtim trupor nuk kishte pësuar, ndërsa kishte pësuar frikë primare të intensitetit posaçërisht të lartë disa sekonda, intensitetit të lartë në kohëzgjatje 40 minuta, intensitetit të mesëm 2 javë ndërsa frika e intensitetit të ulët kishte vazhduar edhe për 1 vit, për të njëjtën kishte qenë e nevojshme përkujdesja e personit tjetër në kohëzgjatje prej 15 ditëve, ndërsa kishte pasur nevojë për ushqim të përforcuar në kohëzgjatje prej 30 ditëve, ndërsa rehabilitimi fizioterapeutik kishte qenë i nevojshëm për 7 ditë. Dëmtimet e pësuar M. K. nga aksidenti i datës 20.08.2022 paraqesin dëmtime të rënda trupore, ashtu që e njëjta kishte pësuar zvogëlim të aktivitetit jetësor 10% për shkak të lëvizshmërisë së kufizuar të bërrylit të dorës dominante në shkallë të mesme pika 1.3.2 b, e njëjta kishte pësuar dhembje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë 1 orë, të intensitetit të rëndë 10 ditë, të intensitetit të mesëm 40 ditë ndërsa dhimbjet fizike të intensitetit të ultë janë të pranishme edhe në ditët e sotme sidomos gjatë ndryshimeve klimatike, kishte pësuar shëmtim trupor të shkallës së lehtë dhe frikë primare të intensitetit posaçërisht të lartë

disa sekonda, intensitetit të lartë në kohëzgjatje 40 minuta, intensitetit të mesëm 4 javë ndërsa frika e intensitetit të ulët vazhdon ende, për të njëjtin kishte qenë e nevojshme përkujdesja e personit tjetër në kohëzgjatje prej 60 ditëve, ndërsa kishte pasur nevojë për ushqim të përforsuar në kohëzgjatje prej 30 ditëve, ndërsa rehabilitimi fizioterapeutik kishte qenë i nevojshëm për 2x10 ditë vitin e parë dhe 2x7 ditë vitin e dytë. Dëmtimet e pësuar V. K.nga aksidenti i datës 20.08.2022 paraqesin dëmtime të lehta trupore, ashtu që i njëjti nuk kishte pësuar zvogëlim të aktivitetit jetësor, i njëjti kishte pësuar dhembje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë 30 minuta, të intensitetit të rëndë 3 ditë, të intensitetit të mesëm 21 ditë ndërsa dhimbjet fizike të intensitetit të ultë nuk ka, shëmtim trupor nuk ka, ndërsa frikë primare të intensitetit posaçërisht të lartë kishte pësuar në kohëzgjatje prej disa sekonda, intensitetit të lartë në kohëzgjatje 40 minuta, intensitetit të mesëm 2 javë ndërsa frika e intensitetit të ulët ka vazhduar edhe për 3 muaj, për të njëjtin kishte qenë e nevojshme përkujdesja e personit tjetër në kohëzgjatje prej 15 ditëve, ndërsa kishte pasur nevojë për ushqim të përforsuar në kohëzgjatje prej 20 ditëve, ndërsa rehabilitimi fizioterapeutik nuk kishte qenë i nevojshëm. Dëmtimet e pësuar N. Sh. nga aksidenti i datës 20.08.2022 paraqesin dëmtime të lehta trupore, ashtu që i njëjti nuk kishte pësuar zvogëlim të aktivitetit jetësor mirëpo i njëjti kishte pësuar dhembje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë 20 minuta, të intensitetit të rëndë 3 ditë, të intensitetit të mesëm 15 ditë ndërsa dhimbjet fizike të intensitetit të ultë nuk ka, nuk kishte pësuar shëmtim trupor, ndërsa frikë primare të intensitetit posaçërisht të lartë nuk kishte pësuar, të intensitetit të lartë në kohëzgjatje 20 minuta, intensitetit të mesëm disa orë ndërsa frika e intensitetit të ulët ka vazhduar për disa javë, për të njëjtin kishte qenë e nevojshme përkujdesja e personit tjetër në kohëzgjatje prej 10 ditëve, ndërsa kishte pasur nevojë për ushqim të përforsuar në kohëzgjatje prej 20 ditëve, ndërsa rehabilitimi fizioterapeutik nuk kishte qenë i nevojshëm.

2.1 Deklarata e ekspertit të psikaitrisë Sh. M.

Eksperti i psikiatrisë Dr.Shaban Mecinaj, në seancën e datës 03.02.2025 ka deklaruar se, mbetet në tërësi pranë ekspertizës së dhënë lidhur me përcaktimin e frikës, kohëzgjatjen dhe intensitetin e saj për 5 paditësit në lëndën C.nr.280/22 dhe nuk ka çfarë të shtoj tjetër.

2.2 Deklarata e ekspertit të ortopedisë Luan Kuqi

Eksperti i ortopedisë Dr.Luan Kuqi në seancën e datës 03.02.2025 kishte deklaruar se mbetet në tërësi pranë ekspertizës mjekësore e cila është përpiluar me shkrim me datë 23.10.2024 ku është bërë ekzaminimi i drejtpërdrejtë i paditësve, duke theksuar se deri te dhembja fizike e intensitetit posaçërisht të rëndë kanë ardhur prej momentit kur ka ndodhur aksidenti deri në

dërgim në qendrën emergjente të spitalit regional të Gjilanit, ku është dashur përafërsisht duke u bazuar në raportet e emergjencës të paktën 30 min deri në 1 orë për të realizuar të gjitha ekzaminimet e nevojshme si klinike ashtu edhe ato imazherike dhe laboratorike të cilat deri në atë moment nuk është ordinar terapi përkatëse kundër dhimbjeve kështu që terapia sipas raporteve të emergjencës është ordinar përafërsisht me një kohëzgjatje disa minuta deri në një orë ku specifikisht nuk mundë të saktësohet sa minuta janë të karakterit shumë të rëndë por përafërsisht sipas lëndimeve të pësuar veç e veç ishte kohë relativisht e mjaftueshme për të zbutur dhimbjet e sipërshënuara, tutje kishte theksuar se për shkak të lëvizshmërisë së kufizuar të bërrylit të dorës dominante në krahasim me ekstremitetin tjetër e cila në vazhdimësi do të ketë probleme me hapjen dhe mbledhjet e bërrylit të involvuar e cila në të ardhmen mund të ketë edhe më shumë rënie të muskulaturës e cila ndikon drejtpërdrejtë në aktivitetet e përditshme rutinore të paditëses M. K., sa i përket paditësit Sh. K. bazuar në raportin e emergjencës të QKUK-së është e vërtetë që në fletën e parë të shënohen të gjitha të dhënat anamnezetike dhe trajtimi që duhet ti jepet palës konsultimet janë të shënuara ku në faqen e dytë , dhe është evidentuar me saktësi nga kirurgu ortoped thyerje e sipër përshkruar dhe tek i njëjti i është ordinar menjëherë konsultat specifike, është kateterizuar dhe është pranuar në klinikën e ortopedisë me qëllim të intervenimit operativ që është dashur të bëhet në një moment të mëvonshëm ndërsa ka theksuar se mendon që për shkak të punëve të shumta që mund të vinë në qendrën emergjente shumë herë teknikisht fleta e parë nuk mbushet pasi që pacienti dërgohet në repart për trajtim, ndërsa kishte theksuar se në raportin e qendrës emergjente të Gjilanit nuk është konstatuar thyerja, por pas ekzaminimeve shtesë imazherike dhe atë të datës 29.08.2022 në ora 13 ku është realizuar CT në një institucion privat “SWISS Hospital” është qartësuar thyerja e tillë dhe si e tillë është ordinar për trajtim në një qendër më të avancuar për intervenim operativ.

3. Baza juridike

Në bazë të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, Ligji Nr. 04/L- 077, neni 136 paragrafi 1, të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, Ligji Nr. 04/L- 077, (LMD-së), është paraparë se “*Kush i shkakton tjetrit dëmin, ka për detyrë ta kompensoj, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij*”. Në bazë të këtij principi pala përgjigjet për dëmin e shkakuar me dashje dhe nga pakujdesia. Çështja e përgjegjësisë subjektive është rregulluar në bazë të nenit 140, të LMD-së. Ndërsa në dispoziten e nenit 169 paragrafi 1, të LMD-së, është paraparë se “*Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi*”, kurse

me dispoziten e nenit 174 të po këtij ligji, është paraparë se “grykata duke marrë parasysh edhe rrethanat që janë shkaktuar pas shkaktimit të dëmit, do të grykojë shpërblimin në një shumë e cila është e nevojshme që gjendja materiale e të dëmtuarit të sillet në atë gjendje në të cilën do të kishte qenë po të mos kishte veprim dëmtues apo mosveprim”. Në dispozitën e nenit 179 paragrafi 1 të LMD-së, përcaktohet se “Kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmtton shëndetin ka për detyrë të shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet tjera të nevojshme lidhur me këtë, si dhe fitimin e humbur për shkak të paaftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit”, Neni 172 paragrafi 1 të LMD-së, është paraparë se “Në rast të vdekjes, të lëndimit trupor ose të dëmtimit të shëndetit, shpërblimi caktohet, sipas rregullës, në formë të rentës në të holla, për gjithë jetën ose për një kohë të caktuar”, kurse me dispozitën e nenit 183 paragrafi 1 të LMD-së parashihet se “Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, grykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të grykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material”, në dispozitën e nenit 9 dhe 10 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia, me numër 04/1-018, ku përcaktohet se “Sigurimi nga auto përgjegjësia mbulon dëmet në persona dhe pasuri të shkaktuara palëve të treta nga përdorimi i mjetit motorik”, “kompensimi i dëmit material dhe jo material bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve”, Ndërsa në nenin 26 paragrafi 1 të të njëjtit ligj përcaktohet se “Siguruesi është i detyruar që, për dëmet në persona, më së largu në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh, ndërsa për dëme në pasuri, më së largu në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës për dëmshpërblim, të trajtojë kërkesën dhe të njoftojë me shkrim palën e dëmtuar me: 1.1. ofertën për dëmshpërblim me shpjegime përkatëse; 1.2. vendimin dhe arsyet ligjore të refuzimit të kërkesës për dëmshpërblim, kur janë kontestuese përgjegjësia dhe lartësia e dëmit.” Ndërsa në paragrafin 6 të po të njëjtit nen përcaktohet se “Në rast të mosrespektimit të afateve të përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni, dhe mos përmbushjes së detyrimit në pagesën e paradhënies nga paragrafi 4. i këtij neni, siguruesi përgjegjës konsiderohet të jetë në vonesë në përmbushjen e detyrimit për dëmshpërblim, duke u ngarkuar me pagesë të interesit për vonesë. Ky interes paguhet në lartësi prej 12 % të interesit vjetor dhe llogaritet për çdo ditë vonesë deri në shlyerjen e dëmshpërblimit nga siguruesi përgjegjës, duke filluar nga data e paraqitjes së kërkesës për dëmshpërblim”

Gjykata nga të lartcekurat dhe duke marrë parasysh bazën ligjore të lartë cituar, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe e aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve. Në rastin konkret, në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar, gjykata e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4. Vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Duke i marrë parasysh provat materiale të administruara, si dhe dispozitat ligjore të lartcekura, gjykata ka ardhur në përfundim se paditësit me datën 20.08.2022, rreth orës 17:20 min, në hyrje të fshatit Hodonoc, kanë pësuar lëndime të rënda trupore si pasojë e aksidentit të trafikut i cili aksident kishte ardhur pasi që Nj.A ishte duke lëvizur në rrugën lokale Crep – Rogoqicë dhe me të arritur në hyrje të fshatit Hodonoc, afër pikës së karburanteve “Ismajli Petroll” fillon tejkalim të pa sigurtë në vijë të plotë dhe në këtë situatë ndeshet në mënyrë ballore me njësinë “B” e cila në momentin kritik ishte duke lëvizur në relacionin Rogoqicë – Crep dhe ishte në shiritin e vet qarkullues, ku si pasojë e këtyre veprimeve shkaktohet aksident trafiku me dëme materiale në të dyja njësitë dhe lëndime trupor pësojnë të dy drejtuesit dhe pasagjerët e njësisë “B”, ku drejtues i nj.A ishte E. K. i cili e drejtonte automjetin VW me tabela 06-307-ER si shkaktar i aksidentit dhe në momentin e shkaktimit të aksidentit ishte i siguruar tek e paditura PRISIG. Nga i cili aksident lëndime të rënda pëson paditësi Sh. K. dhe M.K., ku të njëjtit përkatësisht paditësi Sh. K. kishte pësuar edhe zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm mjekësor në prej 14.50% , M. K. në shkallë prej 10% ndërsa R. K., V. K. dhe N. Sh. pësojnë lëndime të lehta trupore.

Në bazë të provave materiale të administruara, Gjykata në emër të dhimbjeve fizike - trupore, e ka aprovuar pjesërisht kërkesën e paditësve si në dispozitiv dhe e vlerësojë si një shpërblim të drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit sepse paditësit sipas mendimit të ekspertëve mjekësor ortoped – dhe psikiatër, për paditësin Sh. K., dëmtimet e pësuar nga aksidenti i datës 20.08.2022 paraqesin dëmtime të rënda trupore, ashtu që i njëjti kishte pësuar plagë shqyese dermishëse në regjionin ballor majtas e qepur dhe therje të shumëfishtë e acetabulumit të djathtë, dhe kishte pësuar zvogëlim të aktivitetit jetësor 14.50% për shkak të lëvizshmërisë së kufizuar të kërdhokullës së djathtë në shkallë të mesme pika 2.2.2 b si dhe dhimbjes së përhershme për shkak të thyerjes së kockës ischiatike pika 4.1.1 dhe përlloritur sipas Balthazard, i njëjti kishte pësuar dhembje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë 1 orë, të intensitetit të rëndë 15 ditë, të intensitetit të mesëm 60 ditë ndërsa dhimbjet fizike të intensitetit

të ultë janë të pranishme edhe në ditët e sotme sidomos gjatë ndryshimeve klimatike, kishte pësuar shëmtim trupor të shkallës së mesme, për të njëjtin kishte qenë e nevojshme përkujdesja e personit tjetër në kohëzgjatje prej 60 ditëve, ndërsa kishte pasur nevojë për ushqim të përforcuar në kohëzgjatje prej 60 ditëve, ndërsa rehabilitimi fizioterapeutik kishte qenë i nevojshëm për 3x10 ditë në vitin e parë dhe 2x10 ditë në vitin e dytë, ndërsa 10 ditë për 3 vitet tjera, ndërsa lëndimet e paditëses R. K. nga aksidenti i datës 20.08.2022 paraqesin dëmtime të lehta trupore, ashtu që e njëjta nuk kishte pësuar zvogëlim të aktivitetit jetësor ndërsa, kishte pësuar dhembje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë 30 minuta, të intensitetit të rëndë 5 ditë, të intensitetit të mesëm 25 ditë ndërsa dhimbjet fizike të intensitetit të ultë janë të pranishme edhe në ditët e sotme sidomos gjatë ndryshimeve klimatike, shëmtim trupor nuk kishte pësuar, për të njëjtën kishte qenë e nevojshme përkujdesja e personit tjetër në kohëzgjatje prej 15 ditëve, ndërsa kishte pasur nevojë për ushqim të përforcuar në kohëzgjatje prej 30 ditëve, ndërsa rehabilitimi fizioterapeutik kishte qenë i nevojshëm për 7 ditë, ndërsa lëndimet e paditëses M. K. nga aksidenti i datës 20.08.2022 paraqesin dëmtime të rënda trupore, ashtu që e njëjta kishte pësuar zvogëlim të aktivitetit jetësor 10% për shkak të lëvizshmërisë së kufizuar të bërrylit të dorës dominante në shkallë të mesme pika 1.3.2 b, e njëjta kishte pësuar dhembje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë 1 orë, të intensitetit të rëndë 10 ditë, të intensitetit të mesëm 40 ditë ndërsa dhimbjet fizike të intensitetit të ultë janë të pranishme edhe në ditët e sotme sidomos gjatë ndryshimeve klimatike, kishte pësuar shëmtim trupor të shkallës së lehtë, për të njëjtën kishte qenë e nevojshme përkujdesja e personit tjetër në kohëzgjatje prej 60 ditëve, ndërsa kishte pasur nevojë për ushqim të përforcuar në kohëzgjatje prej 30 ditëve, ndërsa rehabilitimi fizioterapeutik kishte qenë i nevojshëm për 2x10 ditë vitin e parë dhe 2x7 ditë vitin e dytë, ndërsa lëndimet e paditësit V.K. nga aksidenti i datës 20.08.2022 paraqesin dëmtime të lehta trupore, ashtu që i njëjti nuk kishte pësuar zvogëlim të aktivitetit jetësor, i njëjti kishte pësuar dhembje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë 30 minuta, të intensitetit të rëndë 3 ditë, të intensitetit të mesëm 21 ditë ndërsa dhimbjet fizike të intensitetit të ultë nuk ka, shëmtim trupor nuk ka, për të njëjtin kishte qenë e nevojshme përkujdesja e personit tjetër në kohëzgjatje prej 15 ditëve, ndërsa kishte pasur nevojë për ushqim të përforcuar në kohëzgjatje prej 20 ditëve, ndërsa rehabilitimi fizioterapeutik nuk kishte qenë i nevojshëm, ndërsa lëndimet e paditësit N. Sh. nga aksidenti i datës 20.08.2022 paraqesin dëmtime të lehta trupore, ashtu që i njëjti nuk kishte pësuar zvogëlim të aktivitetit jetësor mirëpo kishte pësuar dhembje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë 20 minuta, të intensitetit të rëndë 3 ditë, të intensitetit të mesëm 15 ditë ndërsa dhimbjet fizike të intensitetit të ultë nuk ka, nuk kishte pësuar shëmtim trupor, për të njëjtin kishte qenë e nevojshme përkujdesja e personit tjetër në kohëzgjatje prej 10 ditëve,

ndërsa kishte pasur nevojë për ushqim të përforcuar në kohëzgjatje prej 20 ditëve, ndërsa rehabilitimi fizioterapeutik nuk kishte qenë i nevojshëm.

Në emër të frikës së pësuar, gjykata paditësve i ka aprovuar pjesërisht kërkesën dhe ka caktuar shpërblimin si në dispozitiv, të cilën e ka vlerësuar si shpërblim të drejtë duke u nisur nga fakti se sipas mendimit të ekspertit mjekësor të psikiatrisë, paditësit kanë pësuar frikë ashtu që paditësi Sh. K. kishte pësuar frikë primare të intensitetit posaçërisht të lartë disa sekonda, intensitetit të lartë në kohëzgjatje 40 minuta, intensitetit të mesëm 4 javë ndërsa frika e intensitetit të ulët vazhdon ende, ndërsa paditësja R. K. kishte pësuar frikë primare të intensitetit posaçërisht të lartë disa sekonda, intensitetit të lartë në kohëzgjatje 40 minuta, intensitetit të mesëm 2 javë ndërsa frika e intensitetit të ulët kishte vazhduar edhe për 1 vit, paditësja M. K. dhe frikë primare të intensitetit posaçërisht të lartë disa sekonda, intensitetit të lartë në kohëzgjatje 40 minuta, intensitetit të mesëm 4 javë ndërsa frika e intensitetit të ulët vazhdon ende, paditësi V. K. frikë primare të intensitetit posaçërisht të lartë kishte pësuar në kohëzgjatje prej disa sekonda, intensitetit të lartë në kohëzgjatje 40 minuta, intensitetit të mesëm 2 javë ndërsa frika e intensitetit të ulët ka vazhduar edhe për 3 muaj si dhe paditësi N. Sh. frikë primare të intensitetit posaçërisht të lartë nuk kishte pësuar, të intensitetit të lartë në kohëzgjatje 20 minuta, intensitetit të mesëm disa orë ndërsa frika e intensitetit të ulët ka vazhduar për disa javë.

Ndihma dhe kujdesi i huaj 60 ditë për paditësin Sh. K., 15 ditë për paditësen R. K., 30 ditë për paditësen M. K., 15 ditë për paditësin V. K. dhe 10 ditë për paditësin N. Sh. nënkupton ndihmën mjekësore profesionale dhe ndihmë jo profesionale nga personat tjerë, ndihmë e ofruar për personin e lënduar e cila i ka mundësuar plotësimin e nevojave elementare biologjike siç janë: veshmbathja, higjiena personale, ushqimi, kryerja e nevojave të rregullta fiziologjike, kontrollet e rregullta specialistike, pasi këto nevoja nuk ka mundur ti plotësoj vetë si pasojë e paaftësisë të pjesshme e shkaktuar nga lëndimet.

Ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm për 60 ditë për paditësin Sh. K., 30 ditë për paditësen R. K., 40 ditë për paditësen M.K., 20 ditë për paditësin V.K. dhe 20 ditë për paditësin N.Sh., që nënkupton ushqimin e pasuruar me proteina, minerale, vitamina, karbohidrate të nevojshme për ngjitjen dhe sanimin e lëndimit si dhe pasojave të reaksionit post traumatik.

Rehabilitimi fizioterapik, për paditësin Sh. K. kishte qenë i nevojshëm për 3x10 ditë në vitin e parë dhe 2x10 ditë në vitin e dytë, ndërsa 10 ditë për 3 vitet tjera, për paditësen R. K. rehabilitimi fizioterapeutik kishte qenë i nevojshëm për 7 ditë, për paditësen M.K. rehabilitimi fizioterapeutik kishte qenë i nevojshëm për 2x10 ditë vitin e parë dhe 2x7 ditë vitin e dytë.

Në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, në shkallë prej 14.50% për paditësin Sh. K., ndërsa 10% për paditësen M. K. gjykata e ka aprovuar shumën si në dispozitiv duke e vlerësuar si shpërblim të drejtë, ashtu që ia fali besimin konstatimit të ekspertit edhe në këtë pjesë andaj, duke konsideruar se shumica e tillë, paraqet satisfakacion të drejtë për tejkalimin me më lehtësi të pasojave të kësaj forme të dëmit të shkaktuar.

Duke u bazuar në dispozitat e cekura më lartë si dhe duke i vlerësuar të gjitha kriteret dhe masat për caktimin e lartësisë së shpërblimit të dëmit jo material, e posaçërisht duke marrë parasysh natyrën dhe shkallën e dëmtimeve trupore të shkaktuara paditësve, moshën e tyre, në bazë të vlerësimit të ekspertizës mjekësore të përshkruar si më lartë, gjykata aprovojë pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve në vlerat shpërblimit të dëmit si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimit, duke e vlerësuar si shpërblim real, objektive dhe me bindje se ky shpërblim është në pajtueshmëri me natyrën dhe pasojat e lëndimit.

Gjykata konsideron se shumica e gjykuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, paraqesin një satisfakacion moral dhe shpagim real për format e dëmeve të pësuar të paditëses në aksidentin e komunikacionit të datës 20.08.2022, lëndimet dhe pasojat, duke marrë parasysh edhe kriteret e parapara me dispozitën e nenit 200, të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, standardin jetësor të qytetarëve të Kosovës dhe praktikën e deri tanishme të gjykatave të Kosovës.

Lidhur me shumica e gjykuara për paditësit që kanë të bëjnë me kompensimin e dëmit material në emër të ndihmës dhe përkujdesjes nga personi i tretë gjykata vendosi duke e pasur parasysh konstatimin e ekspertit mjekësor i cili ka konstatuar se nevoja për ndihmë dhe përkujdesje nga personi i tretë ka qenë 60 ditë për paditësin Sh. K., 15 ditë për paditësen R. K., 30 ditë për paditësen M. K., 15 ditë për paditësin V.K.dhe 10 ditë për paditësin N.Sh..

Duke u bazuar po ashtu në konstatimin e ekspertit mjekësor i cili ka konstatuar se ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm për 60 ditë për paditësin Sh. K. i pasur me vitamina, minerale, proteina kohë e domosdoshme për konsolidimin e kockave dhe indeve të buta, 30 ditë për paditësen R. K. i pasur me vitamina, minerale, proteina kohë e domosdoshme për konsolidimin e kockave dhe indeve të buta, 40 ditë për paditësen M. K. i pasur me vitamina, minerale, proteina kohë e domosdoshme për konsolidimin e kockave dhe indeve të buta, 20 ditë për paditësin V. K. i pasur me vitamina, minerale, proteina kohë e domosdoshme për konsolidimin e kockave dhe indeve të buta dhe 20 ditë për paditësin N. Sh. i pasur me vitamina, minerale, proteina kohë e domosdoshme për konsolidimin e kockave dhe indeve të buta.

Gjykata ka vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi sa i përket dëmit material të pësuar nga paditësit, duke marr për bazë praktikën gjyqësore në Republikën e Kosovës. Gjykata e ka marr për bazë kohëzgjatjen e nevojës për ndihmë dhe përkujdesje nga personi i tretë dhe ushqimin e përforcuar të konstatuar në ekspertizë mjekësore të ortopedisë dhe traumatologjisë të cekur si më lartë për paditësit, si dhe nga fakti që praktika gjyqësore i njeh rastet e tilla të kompensimit. Në këtë drejtim, duhet të merret parasysh fakti se për këto forma të dëmit në shumicën dërmuese të rasteve palët e kanë të pamundur apo shumë të vështirë të sigurojnë dëshmi konkrete, pasi që kryesisht kujdesin ndaj të dëmtuarve e bëjnë familjarët e tyre dhe ushqimi i përforcuar i cili përfshinë ushqim shtesë të ushqimit të zakonshëm, është vështirë të argumentohet me prova konkrete. Mirëpo, pasi që paditësit kanë pasur nevojë për ndihmën e huaj dhe ushqim të përforcuar (të cekur sikurse në ekspertizën e cekur më lartë), të njëjtëve ligjërisht i takon ky lloj i kompensimit të dëmit i kërkuar në shumat e gjykuara.

Gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ku pas vlerësimit të të gjitha provave të administruara dhe fakteve të vërtetuara, gjykatës i rezultoi se kërkesëpadia e paditësve përtej shumës së aprovuar janë kërkesa të pabazuar, pasi gjykata vlerësoi se shumat e gjykuara janë të përshtatshme dhe në përputhje edhe me natyrën e lëndimeve të paditësve. Gjykata ka konstatuar se lëndimet e këtu paditësve janë lëndime të rënda trupore por, që shumat e aprovuara në emër të kompensimit, janë në harmoni me dëmet jo materiale dhe materiale të pësuar nga paditësit, si pasojë e aksidentit të komunikacionit të datës 20.08.2022. Duke i marrë parasysh këto gjykata e ka refuzuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditësit në lidhje me dëmet jo materiale dhe materiale në lartësi prej 33,521.10 (tridhjetë e tremijë e pesëqind e njëzetënjë euro e dhjetë cent, shumë kjo përtej shumës së gjykuar si në pikën I, II, III, të dispozitivit të këtij aktgjykimi sepse nuk gjeti bazë ligjore e materiale për mbështetje të kërkesës së palës paditëse, pasi që caktimi i shumave më të larta nuk do të ishte në proporcion me dëmin e pësuar nga këtu paditësja.

Gjykata i ka vlerësuar edhe provat tjera materiale të administruara në shqyrtimin kryesor, por erdhi në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen meritore të kësaj çështje juridike kontestimore.

Për kamatën, gjykata vendosi në bazë të nenit 382 të LMD-së dhe mendimit juridik të Gjykatës Supreme lidhur me kamatën.

5. Shpenzimet e procedurës

Gjykata vendosi lidhur me shpenzimet e procedurës, në atë mënyrë që e detyroi të paditurën Kompania e Sigurimeve PRISIG me seli në Prishtinë që në emër të shpenzimeve të procedurës t'ia paguajnë paditësit shumën prej 1,988.00 €. Lidhur me këtë mënyrë të vendosjes, Gjykata iu referua dispozitës nga neni 452 par.2 të LPKsë, e cila përcakton që: *"Po që se paditësi vetëm pjesërisht ka sukses në procesin gjyqësor, atëherë gjykata mundet, duke marrë parasysh suksesin e arritur, të caktojë që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta apo që njëra palë t'ia shpërblejë tjetrës, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, pjesën proporcionale të shpenzimeve"*. Në rastin konkret, përfaqësuesi i autorizuar i paditësi ka paraqitur kërkesë të specifikuar për kompensimin e shpenzimeve të procedurës në shumën e përgjithshme prej 3,630.40 €. Gjykata mori në konsideratë faktin se nga tërësia e vlerës së kontestit prej 74,095.10 €, pjesa e aprovuar e kërkesëpadisë konsiston në shumën prej 40,574.00 €, që nënkupton se shkalla e përgjithshme e suksesit në këtë procedurë arrin në nivelin prej 54,76 %. Mbi këtë bazë, Gjykata erdhi në përfundim se paditësit nga të paditurit duhet t'i kompensohen shpenzimet e kësaj procedure në shumën prej 1,988.00 € ($3,630.40 \times 54.76 \% = 1,988.00$), shumë kjo proporcionale me suksesin e arritur në procedurë.

Duke u bazuar në të lartcekurat, si dhe në dispozitat e nenit 136 paragrafi 1, 140, 159 paragrafi 1 dhe 245, të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, Ligji Nr. 04/L- 077, si dhe në dispozitën e nenit 14, lidhur me dispoziten e nenit 143 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2022:237972, 18.02.2025**

G j y q t a r j a,

Valbonë Dërvodeli, d.v.

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditëve, pas ditës së pranimit të të njëjtit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës, në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.